

VENDIM
Nr.80, datë 14.11.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË ENERGJISË REAKTIVE PËR SUBJEKTET
JOFAMILJARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.109, datë 22.2.2006 “Për normën e lejuar të faktorit të fuqisë”, Kodit të Sistemit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.58, datë 28.12.2004, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2006, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.a., për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamiljare,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë reaktive është 15% e çmimeve të energjisë aktive.
2. Aplikimi i tarifave të energjisë reaktive do të fillojë nga data 1 tetor 2006.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta